



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË

[Datë: 25/09/2020]

Për: Operatorin ekonomik "Erisoni Company" shpk
Adresa: Njësia Bashkiake nr. 7, Rruga Shefqet Musaraj, Pallati nr. 3, Kati I-rë, Tiranë

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

* * *

Procedura e prokurimit: "Kërkesë për propozim"

Referenca e procedurës: REF-68881-08-17-2020

Përshkrim i shkurtër i kontratës: "Mirëmbajtje e pajisjeve të zyrave për Bashkinë e Tiranës"

Fondi limit: 4.144.000 (katër milion e njëqind e dyzetë e katër mijë) lekë pa tvsh

Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin: Një vit duke filluar nga data e lidhjes së kontratës.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 28/08/2020, ora 12.00

Publikime të mëparshme: Buletini i Njoftimeve Publike: Nr. 59 datë 24 Gusht 2020

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X

Njoftojmë se, ka qenë pjesëmarrës në procedurë ofertuesi me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik "BNT ELECTRONICS" SHPK NUIS J61817047D

Vlera e ofertës pa tvsh– 3.886.955 (tre milion e tetëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e pesë) lekë

Vlera e ofertës me tvsh– 4.664.346 (katër milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e treqind e dyzetë e gjashtë) lekë

2. Operatori ekonomik "ERISONI COMPANY" SHPK NUIS K92006501A

Vlera e ofertës pa tvsh– 3.626.900 (tre milion e gjashtëqind e njëzetë e gjashtë mijë e nëntëqind) lekë

Vlera e ofertës me tvsh– 4.352.280 (katër milion e treqind e pesëdhjetë e dy mijë dyqind e tetëdhjetë) lekë

3. Operatori ekonomik "FASTECH" SHPK NUIS J81609010U

Vlera e ofertës pa TVSH– 3.683.700 (tre milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e tre mijë e shtatëqind) lekë

Vlera e ofertës me tvsh– 4.420.440 (katër milion e katërqind e njëzetë mijë e katërqind e dyzetë) lekë

4. Operatori ekonomik "FREDI ELECTRONIC" SHPK NUIS K91803020F

Vlera e ofertës pa tvsh– 3.485.000 (tre milion e katërqind e tetëdhjetë e pesë mijë) lekë

Vlera e ofertës me tvsh– 4.182.000 (katër milion e njëqind e tetëdhjetë e dy mijë) lekë

5. Operatori ekonomik "PC STORE SHPK NUIS L01606034A

Vlera e ofertës pa tvsh– 3.682.000 (tre milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e dy mijë) lekë

Vlera e ofertës me tvsh– 4.418.400 (katër milion e katërqind e tetëmbëdhjetë mijë e katërqind) lekë

6. Operatori ekonomik "TE ELECTRONICS" SHPK NUIS L41307020G

Vlera e ofertës pa tvsh– 3.749.000 (tre milion e shtatëqind e dyzetë e nëntë mijë) lekë

Vlera e ofertës me tvsh– 4.498.800 (katër milion e katërqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e tetëqind) lekë

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

Operatori ekonomik “FREDI ELECTRONIC” SHPK

NUIS K91803020F

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik “Fred Electronics” shpk ka dorëzuar shtojcën 2/1 Deklaratë për Ofertë të pavarur të kërkuar në dokumentat e procedurës së prokurimit, por në pikën 6 të saj vërehet se nuk është plotësuar si duhet pasi nuk ka klikuar njërin nga alternativat duke i lënë ato të paplotësuara.

Në nenin 46, pika 1, të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”*. Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”*. Referuar sa më sipër, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se operatori ekonomik “Fred Electronics” shpk nuk plotëson kriterin e vecantë të kualifikimit, pasi ka paraqitur shtojcën 2/1 “Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur” pjesë e dokumentave të tenderit por në pikën 6 të saj vërehet se nuk është plotësuar si duhet pasi nuk ka klikuar njërin nga alternativat duke i lënë ato të paplotësuara. Në pikën 2 të kësaj shtojce ku përcaktohet se: *“Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s’kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga pjesëmarrja në prokurimet publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt”* pra operatori ekonomik në statusin e palës së interesuar në këtë proces për të fituar kontratën me nënshkrimin e kësaj deklarate ka shprehur dakortësinë e tij me cdo pikë të saj edhe konkretisht me pikën 2 e cila e penalizon ofertuesin palë në process në rast të mosplotësimit sic duhet të kësaj shtojce.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave sqaron se, në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kriteret kualifikuese dhe kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me kërkesat e dokumentave të tenderit dhe legjislacionin në fuqi. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se kriteret e veçanta për kualifikim kanë si synim kryesor që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu vlen të përmendet që ekzistojnë edhe vendime të Komisionit të Prokurimit Publik i cili është edhe organi më i lartë i trajtimit të ankesave në fushën e prokurimit publik që e konsideron mosplotësimin e kësaj shtojce në formën e duhur shkak për s’kualifikim të operatorit ekonomik që është palë në një proces prokurimi. Bazuar në nenin 1 dhe nenin 2 të LPP, në të cilët përcaktohet përkatësisht: *“Qëllimi i këtij ligji është: [...] të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik”*; *“Përzgjedhja e fituesve të kontratave publike realizohet në përputhje me këto parime të përgjithshme: a) mosdiskriminim dhe trajtim i barabartë i*

ofertuesve ose kandidatëve; b) transparencë në procedurat e prokurimit; c) barazi në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve”, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se operatori ekonomik “Fred Electronics” shpk duhet të kishte paraqitur shtojcën 2/1 të plotësuar në formën e duhur.

Sa më sipër Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Operatorin ekonomik “Erisoni Company” shpk** me adresë: Njësia Bashkiake nr. 7, Rruga Shefqet Musaraj, Pallati nr. 3, Kati I-rë, Tiranë, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 3.626.900 (tre milion e gjashtëqind e njëzetë e gjashtë mijë e nëntëqind) lekë pa tvsh dhe 1.922.280 (një milion e nëntëqind e njëzetë e dy mijë e dyqind e tetëdhjetë) lekë me TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi, por jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e marrjes së kërkesës nga Autoriteti Kontraktor për lidhjen e kontratës.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të veprohet sic parashikohet në neni 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: 16.09.2020

Ankesa: Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Neni 63 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, **nuk është paraqitur asnjë ankesë.**